

HR - 10000 Zagreb

Savica I. 127
T +385 (0)1 2352 200
F +385 (0)1 2352 299
info@stormgrupa.hr
www.stormgrupa.hr



RN: 2360000-1102161570
MB: 2675323
OIB: 12846753194

Zagreb, 17 Mars, 2020

Titulli: Njoftim për partnerët dhe klientët – Masat ndaj COVID-19 në STORM Group

Të nderuar partnerë, klientë dhe kolegë

Situata në Kroaci po përkeqësohet me virusin corona (COVID-19), po prek të gjithë ne, si dhe biznesin tonë me të gjithë partnerët dhe klientët tanë.

Ne po ju dërgojmë këtë njoftim për t'ju siguruar informacion të dobishëm në lidhje me atë që aktualisht ne jemi duke bërë dhe planifikuar, me qëllim për të siguruar vazhdimësinë e biznesit dhe përkrahjes tonë për të gjithë ju me sa më pak rrezik për shëndetin e të gjithëve.

Prioriteti ynë është të vazhdojmë të sigurojmë shërbim dhe përkrahje të plotë për të gjithë partnerët dhe klientët tanë, të kujdesemi për shëndetin e të gjithë punonjësve dhe klientëve tanë. Si një kompani e përgjegjshme, ne monitorojmë situatën aktuale në baza ditore. Në të gjithë Grupin STORM, ne kemi formuar një ekip brenda Bordit Drejtues i cili bazuar në udhëzimet e autoriteteve shëndetësore dhe institucioneve zbaton të gjitha masat e nevojshme të sigurisë në lidhje me punën tonë, duke marrë parasysh shëndetin e të gjithë neve dhe duke siguruar vazhdimësinë e biznesit.

Ne jemi në kontakt me të gjithë shitësit tanë, partnerë vendas dhe të huaj, të cilët do të vazhdojnë të përmbushin të gjitha detyrimet e tyre me ne në përputhje me rekomandimet dhe urdhërat e autoriteteve shëndetësore.

Duke marrë parasysh të gjitha më sipër, ne kemi miratuar një numër masash për të maksimizuar vazhdimin e aktiviteteve tona të biznesit dhe përmbushjen e detyrimeve tona, në përputhje me rethanat:

- Të gjitha kompanitë e STORM Group vazhdojnë aktivitetet e tyre të biznesit dhe ofrojnë mbështetje të plotë ndaj klientëve të tyre
- Të gjitha kompanitë e STORM Group vazhdojnë furnizimin me mallra dhe të ofrojnë shërbime sipas rrethanave dhe mundësive, përveç nëse ato ndikohen nga ngjarje përtej kontrollit tone
- Ne minimizojmë takimet e drejtpërdrejta dhe rekomandojmë përdorimin maksimal të konferencave dhe video konferencave
- Ne i kemi kufizuar të gjitha udhëtimet e biznesit, përveç atyre që lidhen me punën në terren dhe ndërhyrjet tek klientët

- Ne kemi ndarë punonjësit tanë në ekipe, nga shtëpia dhe vendi i punës, ekipet për të mundësuar funksionalitetin e plotë të të gjitha proceseve tona të biznesit dhe përkrahjen e plotë për klientët tanë
- Të gjithë punonjësit tanë, qoftë nga shtëpia apo nga vendi i punës, janë në dispozicion ndaj gjithë klientëve tanë në çdo kohë
- Ne u kemi ofruar të gjithë punonjësve tanë, të cilët për shkak të natyrës së punës, janë në kontakt fizik me klientët, udhëzime të rrepta për procedurën dhe zbatimin e masave higjienike, dhe atyre do t'u sigurohet mbrojtja maksimale shëndetësore gjatë kryerjes së detyrave të përmendura (pastrim i zgjeruar i hapësirës, dezinfektim dhe kushte të tjera të nevojshme higjienike).

Është e rëndësishme të përmendet edhe një herë, ne vazhdojmë me të gjitha aktivitetet e planifikuara të biznesit për aq sa lejojnë rrethanat, dhe derisa të shpallen masa shtesë nga institucionet shëndetësore, me kujdes të shtuar dhe zbatimin e të gjitha masave parandaluese të deklaruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kroat i shëndetit publik.

Siç u tha më herët, jemi në një kohë shumë sfiduese. Përhapja e virusit corona padyshim që prek të gjithë - punonjësit tanë, përdoruesit tanë dhe familjet tona. Sidoqoftë, të gjitha kompanitë e STORM Group, si kompani teknologjike, kanë të gjithë infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e biznesit dhe përkrahjen për të gjithë klientët tanë, dhe ne do të jemi aty për ju në çdo hap të rrugës.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj në këto kohë delikate,

Ekipi juaj STORM!